



ÇËSHTJET

KRYESORE:

• DITA NDERKOMBETARE E TE DREJTAVE TE NJERIUT

• GJYKATA ADMINISTRATIVE LE NE FUQI VENDIMIN

• NDRYSHIME NË KODIN ZGJEDHOR NË BAZË TË REKOMANDIMEVE TË OSBE/ODIHR-IT

NË VIJIM:

SINJALIZONI AKTET KORRUPTIVE 2

REFLEKTIM PER PROTESTAT STUDENTORE 2

5% PËR ARSIMIN E FËMIJEVE DHE TË RINJVE TANË! 2

MONITORIMI I PROCESIT TË VETTING-UT 3

MBI SITUATËN E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT NË SHQIPËRI GJATË VITIT 2018 3

I NEVOJSHËM KON-SULTIMI REAL DHE DËGJESAT ME BANORËT E UNAZËS SË RE 4

NDODHITE NE BULERAT 4

AUTORITETET SHQIPTARE URDHËROHEN TË OFROJNË UJË TË PASTER 4

THIRRJE DREJTUAR ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK TIRANË 4

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

BULETIN

NR. 3

NENTOR-DHJETOR 2018

Klinika Ligjore

DITA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Në ditën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, përkujtojmë 70 vjetorin e miratimit të nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. Deklarata përfaqëson përpjekjen e parë globale për të artikuluar mbrojtjen e atyre të drejtave që shumë njerëz besonin se ishin të drejta themelore që i takojnë të gjitha qenieve njerëzore.

Sot, mos respektimi i të drejtave të shtetasve vazhdon të jetë një problem me përhapje të gjerë në të gjitha pjesët e globit, duke përfshirë dhe vendin tonë. Ne vlerësojmë se pjesëmarrja e të rinjve është një vlerë që duhet promovuar dhe përbën një nga parimet orientuese të Deklaratës. Përkundrejt këtyre vlerave, vërejmë me shqetësim që një pjesë e të rinjve vazhdojnë të largohen nga Shqipëria drejt vendeve të BE-së për një të ardhme më të mirë. Për më shumë informacion lexoni:

[ARTIKULL](#)



NDRYSHIME NË KODIN ZGJEDHOR NË BAZË TË REKOMANDIMEVE TË OSBE/ODIHR-IT

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) shpreh shqetësimin se në kalendarin e punimeve të Kuvendit për periudhën 3 Dhjetor – 21 Dhjetor 2018 nuk është parashikuar asgjë për diskutimin apo miratimin e ndryshimeve të Kodit Zgjedhor në bazë të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it. Duket se deklaratat e bëra se ndryshimet në Kodin Zgjedhor do të miratoheshin brenda muajit dhjetor të këtij viti nuk do të realizohen.

KShH duke patur parasysh përvojën negative të zgjedhjeve të vitit 2017, kur në Kodin Zgjedhor nuk u bë asnjë ndryshim, si dhe vështirësitë që u krijuan në këtë rast, i bën thirrje mazhorancës dhe opozitës që me dialog, transparencë dhe konsensus të vlerësojmë maksimalisht këtë çështje.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SE PARE TIRANE LE NE FUQI VENDIMIN E KOMISIONERIT PER MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI



Më datë 19 Nëntor 2018, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë u shpreh pozitivisht duke lënë në fuqi Vendimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Nëpërmjet kësaj vendimmarrje, të iniciuar nga ankesa e depozituar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, konstatohet diskriminimi i të dënuarve që punojnë në sistemin e burgjeve, ndaj të cilëve nuk zbatohet e njëjta praktikë përsa i përket njohjes së punës dhe shpërblimit lidhur me të. Kjo çështje përfaqësohet në kuadër të nismës “Përmirësimi i situatës të të drejtave të njeriut në Shqipëri nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës – Klinika Ligjore XII, e cila mbështetet financiarisht nga Civil Rights Defenders.

[ARTIKULL](#)

Adresa: Rr. “Brigada e VIII”, Pall TeknoProjekt, Ap.10, Kati 5 Tiranë-Shqipëri

Kutia Postare Nr. 1752, Tel: ++355 (0)4 233671, e-mail: office@ahc.org.al, web adresa: www.ahc.org.al

EDUKIM LIG JOR

SINJALIZONI AKTET KORRUPTIVE LEGJSLACIONI PËR BILBILFRYRËSIT (SINJALIZUESIT) JU MBRON KSHH OFRON ASISTENCË LIGJORE PËR KËDO QË VLERËSON SE ËSHTË NË POZITAT E SINJALIZUESIT




Heshtja dhe indiferenca krijon një terren të shëndetshëm për korrupsionin dhe shpërdorimin e detyrës, që në një mënyrë apo në një tjetër prekin direkt jetën e kujtdo. Ti mund të shikosh se si në vendin ku punon ose aplikon për një punë të re, sapo është ushtruar një praktikë korrupsioni. Bilbil fryrja është një reagim qytetar përmes të cilit refuzohet pajtimi me veprimet korruptive. Ligji garanton një procedurë hetimi administrativ të shpejtë dhe të besueshëm, duke u bazuar në parimin e ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit të sinjalizimit dhe sekretit shtetëror. Për me shume klikoni linkun: [ARTIKULL](#)

REFLEKTIM PER PROTESTAT STUDENTORE



Prej gati dy javësh, studentë të universiteteve publike kanë pasur protesta të vazhdueshme lidhur me problematikat me të cilat ata përballen në ndjekjen e studimeve të larta, si dhe kanë kërkuar plotësimin e 8 rekomandimeve drejtuar autoriteteve shtetërore. Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) ka ndjekur protestën jo vetëm me anë të medias, por që në ditët e para të kësaj proteste ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme takime me një përfaqësi studentësh për tu njohur më nga afër me kërkesat e tyre dhe për të diskutuar kontributin e KShH-së në drejtim të këtyre kërkesave. Por pavarësisht nga kontaktet e realizuara me studentë të ndryshëm dhe organizatorë të saj, kërkesa jonë për takim nuk është marrë në konsideratë deri më tani. Për më shumë lexoni: [ARTIKULL](#)

5% PËR ARSIMIN E FËMIJËVE DHE TË RINJVE TANË!



Organizatata e Shoqërisë civile me anë të kësaj deklaratë publike duan të shprehin mbështetjen e tyre për kërkesën e studentëve për rritjen e buxhetit të arsimit në Shqipëri në masën 5 % të prodhimit të përgjithshëm bruto (PBB). Shqipëria investon vetëm 3.3% e PBB-së për arsimin, shifër kjo larg standardit ndërkombëtar dhe atij rajonal. Kjo masë e ulët e investimeve cënon të drejtat e fëmijëve dhe të të rinjve për ofrimin e arsimit publik pa pagesë, cilësor dhe gjithëpërfshirës për të gjithë.

Në vende me të ardhura si Shqipëria, investimi me 1 dollar me shumë në arsim do të gjeneronte të ardhur prej me tepër se 5 dollarë në të ardhurat vjetore të një vendi për person. Për më shumë lexoni: [ARTIKULL](#)



KShH prej gati një viti është duke zbatuar nismën “Të rinjtë luftojnë korrupsionin në Arsimin e Lartë në Shqipëri”, një nismë e cila synon të parandalojë dhe të adresojë format e ndryshme të korrupsionit në sistemin e arsimit të lartë por njëkohësisht synon edhe rritjen e kapaciteteve të studentëve për të qenë lider të një kulture universitare të bazuar në suksesin e ndershëm, aftësinë dhe meritokracinë.



Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) dhe Instituti i Studimeve Politike (ISP) me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë gjatë vitit 2018 kanë kryer monitorimin e procesit të vettingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe ligjërimit politik e publik mbi reformën në drejtësi. Gjetjet kryesore të raporteve përkatëse për periudhat deri në qershor 2018 (vettingu) dhe gusht 2018 (ligjërimi) tregojnë se:

- Reforma në drejtësi vijon të jetë prioriteti kryesor institucional në Shqipëri, por ecuria drejt jetësimit cilësor të saj, vijon të jetë në disproporcion me pritshmërinë publike dhe nevojat institucionale.
- Kuadri i ri ligjor i drejtësisë ende nuk po zbatohet.
- Bilanci i deritanishëm i vettingut është pozitiv, por ende i pamjaftueshëm për të prekur rezultatet e reformës dhe reflektimin në sistemin e ri..... Për më shumë lexoni: [ARTIKULL](#)



Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) në vazhdimësi ka ndarë gjetjet e monitorimit të seancave dëgjimore me gjyqtarët dhe prokurorët të cilët janë subjekt i vettingut. Bashkëpunimi i publikut dhe transparenca e procesit karshi publikut është një nga komponentët më të rëndësishëm të vettingut. KShH ju fton të njiheni me skemat e monitorimit të vëzhguesve të KShH-së për subjektet e rivlerësimit nga muaji Nëntor 2018 dhe në vazhdim. Klikoni linkun më poshtë për të parë gjetjet paraprake.

[REFORMA NË DREJTËSI – VETTINGU I GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE](#)

Ky monitorim realizohet në kuadër të projektit “Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut” – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

MBI SITUATËN E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT NË SHQIPËRI GJATË VITIT 2018



Gjatë vitit 2018, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) ka fokusuar veprimtarinë e tij në fusha të rëndësishme si zbatimimi i reformës në drejtësi, aksesimi në drejtësi i grupeve në nevojë, respektimi i të drejtave të njeriut në institucionet penitenciare, komisariatet e policisë, spitalet psikiatrike, pikat e kalim kufirit dhe qendrat e azilkërkuesve, parandalimi dhe lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe diskriminimit, promovimi i medias së lirë, transparenca dhe mirëqeverisja e institucioneve, mbrojtja e mjedisit, etj.

KSHH ka realizuar monitorime të herëpashershme, ka ndërmarrë fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi ligjor, ka reaguuar publikisht për rastet e shkeljeve flagrante, ka komunikuar me institucionet shtetërore me kërkesa për informacion dhe duke adresuar rekomandime konkrete, ka ofruar shërbime ligjore falas për grupet në nevojë, si dhe ka përfaqësuar çështje me interes publik në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Procesi i vettingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve, edhe pse u shoqërua me disa vonesa, ka ngjallur interes të lartë tek publiku. Shtetasit kanë përcjellë një numër të konsiderueshëm ankesash tek organet e vettingut, por në asnjë rast nuk del që ata të kenë kërkuar statusin e bashkëpunëtorit të drejtësisë. Për më shumë lexoni: [ARTIKULL](#)

GRUPET VULNERABELË



I nevojshëm konsultimi real dhe dëgjuesat me banorët e Unazës së Re (Zona e Astirit)

KShH është njohur dhe ka ndjekur protestat e zhvilluara nga banorët e zonës së Astirit, të qytetit Tiranë, shtëpitë e të cilëve është vendosur të prishen si pasojë e zbatimit të Projektit të ndërtimit të Unazës së Re. Një përfaqësues i Komitetit Shqiptar të Helsinkit zhvilloi një takim ditën e djeshme, me disa prej banorëve të kësaj zone që protestonin për të drejtat e tyre.

KShH vlerëson projektet infrastrukturore që i shërbejnë përmirësimit të cilësisë së transportit rrugor dhe jetës së qytetarëve në qytetin e Tiranës. Edhe pse projekte të tilla mund t'i shërbejnë interesit publik, KShH vlerëson se shteti duhet të testojë në mënyrë proporcionale çdo të drejtë.: [ARTIKULL](#)

NGJARJA NË BULARAT



Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), misioni i të cilit ka qenë dhe mbetet respektimi i lirisë dhe të drejtave të shtetasve, përfshirë këtu edhe ato të pakicave kombëtare, shpreh indinjatën e tij të thellë dhe dënon me forcë atë që ndodhi sot në Bularat. Një grup personash të ardhur nga Greqia shfrytëzuan ceremoninë mortore të shtetasit Kostandin Kacifa, duke e kthyer atë në një ngjarje të tensionuar, ku u shpreh qartazi gjuha e urrejtjes ndaj popullit shqiptar nëpërmjet parullave nacionaliste, edhe ligjërisht. Shfaqje të tilla që i përkasin të kaluarës së largët nuk kanë asgjë të përbashkët me marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë midis popullit shqiptar dhe atij grek, si dhe me standardet europiane, për të jetuar në paqe, demokraci dhe stabilitet. Lexoni: [ARTIKULL](#)

AUTORITETET SHQIPTARE URDHËROHEN TË OFROJNË UJË TË PASTËR PËR ROMËT PAS RASTIT TË DISKRIMINIMIT

Tiranë, Budapest 10 dhjetor 2018: Një komunitet rom në Fushë-Krujë, Shqipëri, ka fituar një rast përpara Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi iu kundërvu bashkisë vendore për refuzimin për t'iu ofruar ujë të pastër të pijshëm dhe higjienë. Komisioneri gjeti se Bashkia e Krujës kishte diskriminuar ndaj familjeve romë që jetonin në lagjen "Kastriot" në bazë të etnisë dhe statusit ekonomik-social të tyre, dhe urdhëroi bashkinë të ndërmarrë masa të menjëhershme për ta korrigjuar situatën ose të përballej me një gjobë. Rasti u dërgua tek Komisioneri nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), me mbështetjen e Qendrës Europiane për të Drejtat e Romëve (ERRC), të cilët ofruar provat për ndarjen etnike në aksesin ndaj ujit në Shqipëri. Lexoni: [ARTIKULL](#)

Thirrje drejtuar anëtarëve të Këshillit Bashkiak Tiranë të mos miratohen disa pika të projektvendimit mbi "Kontrollin e Territorit dhe përcaktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në Bashkinë e Tiranës."



Të nderuar Zonja/ Zotërinj Këshilltarë të Këshillit Bashkiak Tiranë,
Ju drejtohem publikisht dhe me urgjencë për t'ju shprehur shqetësimin tonë në lidhje me disa pika të neneve të propozuara në projektvendimin "Për Kontrollin e Territorit dhe përcaktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në Bashkinë e Tiranës." Ne si organizata të shoqërisë civile jemi të mendimit se më gjithë qëllimin e mirë që mund të kenë pasur propozuesit e këtij projektvendimi, për të përmirësuar aspekte të jetesës në kryeqytet, disa amendamente bien në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut dhe ju kërkohet të mos i miratoni ato. Lexoni [ARTIKULL](#)

Ky buletin është përgatitur në kuadër të projektit "Përmirësimi i situatës të të drejtave të njeriut në Shqipëri nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës – Klinika ligjore XII", zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe mbështetur financiarisht nga organizata Civil Rights Defenders, me fonde të Qeverisë së Mbretërisë Suedeze.



Përmbajtja e këtij buletini është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton qëndrimin e Qeverisë Suedeze ose të organizatës Civil Rights Defenders.

Gjetjet dhe çështjet e publikuara në këtë buletin u mundësuan nga: Civil Rights Defenders, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Ambasada e SHBA-ve në Shqipëri, Komisioni Evropian, Open Society Institute - Budapest, Ambasada e Vendeve të Ulëta në Shqipëri, Ambasada e Britanisë së Madhe, ERRC European Roma Right Community, Komiteti Holandez i Helsinkit, Bank Watch etj.

Adresa: Rr. "Brigada e VIII", Pall TeknoProjekt, Ap.10, Kati 6 Tiranë-Shqipëri

Kutia Postare Nr. 1752, Tel: ++355 (0)4 233671, e-mail: office@ahc.org.al, web adresa: www.ahc.org.al